



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
SEKTORI I SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME**

Nr. 3176/1 prot.

Tiranë, më 16.11.2022

**URDHËR**

Nr. 99, datë 16.11.2022

**“PËR**

**CAKTIMIN E PUNONJËSIT NË ROLIN E ADMINISTRATORIT  
ENERGJETIK GJATË KOHËZGJATJES SË GJENDJES SË EMERGJENCËS  
NË FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE”.**

Në mbështetje të nenit 147/d, të Kushtetutës, të nenit 204, pika 1, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe aktit normativ nr.14, datë 05.10.2022 “Për marrjen e masave të veçanta gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike” të Këshillit të Ministrave,

**URDHËROJ:**

1. Caktimin e Z. Argen Sako Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme në rolin e Administratorit Energjetik gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike.
2. Administratori energjetik zbaton detyrat e përcaktuara në nenin 4 pika 2 të aktit normativ nr.14, datë 05.10.2022 “Për marrjen e masave të veçanta gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike” të Këshillit të Ministrave.
3. Administratori energjetik, raporton çdo datë 28, të çdo muaji pranë titullarit të institucionit dhe Task-Forcës së Energjisë, për kursimet e arritura në raport me muajin përkatës të vitit paraardhës dhe raportimin e masave të zbatuara.
4. Formati i raportimit, pranë titullarit të institucionit dhe Task-Forcës së Energjisë, të jetë sipas formatit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
5. Ngarkohet Drejtorja Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, për njoftimin dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

**INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

**Artur Metani**



ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
 DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHËTETËSE  
 SEKTORI I SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME

Tiranë më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2022

TABELE RAPORTIMI I KONSUMIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE

Nr.	VITI	PERIUDHË FATURIMI	SHUMA/KW	SHUMA/LEKË	VITI	PERIUDHË FATURIMI	SHUMA/KW	SHUMA/LEKË	DIFERENCA	
									(Tregues i kursimit të energjisë)	LEKË
1										
2										
3										
4										
5										
6										
7										
8										
9										
10										

ADMINISTRATORI ENERGETIK